



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 59

**Tiranë – E martë, 19 prill 2022**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                             | Faqe                                                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr. 29/2022,<br>datë 24.3.2022                                                                         | Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e<br>Pjesëhme të Zgjeruar për Rrugët Kulturore, miratuar me rezolutën<br>CM/RES (2013) 66..... 8105                                              |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 13555, datë 13.4.2022                                                           | Për shpallje ligji..... 8110                                                                                                                                                                             |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 13540, datë 7.4.2022                                                            | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8110                                                                                                                                                             |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 13559, datë 13.4.2022                                                           | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 8111                                                                                                                                                   |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 225, datë 13.4. 2022                                                | Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës<br>së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase,<br>rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë..... 8111 |
| Udhëzim i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural nr. 6,<br>datë 11.4.2022                           | Për mjetet që përdoren për peshkimin çlodhës-argëtues dhe<br>mënyrën e lëshimit të autorizimit..... 8113                                                                                                 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit<br>dhe Sportit nr. 7, datë 7.4.2022                                          | Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të<br>sistemit arsimor parauniversitar..... 8122                                                                                         |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural nr. 167,<br>datë 11.4. 2022                         | Për ndalimin e peshkimit në liqenet e Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës<br>dhe Shkopetit..... 8124                                                                                                          |
| Vendim i Autoritetit për<br>Informimin mbi Dokumentet<br>e ish-Sigurimit të Shtetit<br>nr. 6, datë 1.4.2022 | Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 8125                                                                                                                                        |

|                                                                                                    |                                                                                                                                                                |      |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 7, datë 1.4.2022 | Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....                                                                                                   | 8126 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 31.3.2022                                     | Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kw..... | 8129 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59, datë 31.3.2022                                     | Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....                                                      | 8131 |
|                                                                                                    | Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) i shpalljes të zhdukur të shtetasit Bardhul Metushi                                                                              | 8132 |



**LIGJ**  
**Nr. 29/2022**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN**  
**E PJESSHME TË ZGJERUAR PËR**  
**RRUGËT KULTURORE,**  
**MIRATUAR ME REZOLUTËN**  
**CM/RES (2013) 66**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e pjeshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.3.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13555, datë 13.4.2022,**  
**të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Ilir Meta.**

**Rezoluta CM/Res(2013)66**  
**konfirmon krijimin e Marrëveshjes së**  
**Pjeshme të Zgjeruar për Rrugët Kulturore**  
**(EPA)**

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 18 dhjetor 2013 në takimin 1187bis të zëvendësministrave)*

Përfaqësuesit në Komitetin e Ministrave të Andorrës, Austrisë, Azerbajxhanit, Bullgarisë, Qipros, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Italisë, Lituanisë, Luksemburgut, Monakos, Malit të

Zi, Norvegjisë, Portugalisë, Rumanisë, Federatës Ruse, Serbisë, Sllovenisë, Spanjës dhe Zvicrës,

*duke pasur parasysh* suksesin e Programit të Rrugëve Kulturore të Këshillit të Evropës, bazuar në Rezolutat CM/Res (2010)52 dhe CM/Res (2010)53, mbi Rrugët Kulturore të Këshillit të Evropës, të cilat janë bërë mjete thelbësore për rritjen e ndërgjegjësimit mbi trashëgiminë e përbashkët Evropiane, si themeli i qytetarisë evropiane, si një mjet për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe një burim i zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor;

*duke nënvizuar* rëndësinë e rrugëve kulturore, si ilustrime të prekshme, përmes itinerareve ndërkufitare evropiane, të pluralizmit dhe diversitetit të kulturës evropiane, të bazuar në vlerat e përbashkëta dhe si mjete për dialog dhe mirëkuptim ndërkulturor;

*duke pranuar* me kënaqësi se 26 rrugët kulturore tani janë të certifikuara si Rrugë Kulturore të Këshillit të Evropës dhe se aktivitetet e rrjeteve që zbatojnë këto rrugë janë vazhdimisht në rritje, duke përfshirë pjesën më të madhe të Evropës kontinentale dhe më gjerë, duke vënë në dukje gjithashtu se rrugët kulturore tani kryejnë shume ngjarje kulturore, shkëmbime arsimore dhe turne çdo vit, duke përfshirë qindra mijëra njerëz, qindra organizata dhe komunitete lokale;

*duke pranuar* se për të arritur shtrirjen dhe ndikimin maksimal, rrugët ekzistuese kulturore, si dhe shumë të tjera në zhvillim, kërkojnë ndihmë dhe mbështetje profesionale të vazhdueshme;

*duke nënvizuar* kontributin thelbësor të Institutit Evropian të Rrugëve Kulturore me qendër në Luksemburg, në përpilimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe trajtimin e rritjes së kërkesës për asistencë teknike për ngritjen e rrugëve kulturore, dhe duke falënderuar Qeverinë e Luksemburgut për mbështetjen e vazhdueshme dhe bujare për Institutin gjatë shumë viteve;

*duke marrë parasysh* angazhimin e Qeverisë së Luksemburgut në vazhdimin e dhënies së një kontributi vjetor vullnetar për të mbuluar kostot operacionale të Institutit Evropian të Rrugëve Kulturore, në mënyrë që t'i mundësojë atij të përmbushë detyrat që i janë dhënë nga EPA dhe nga Marrëveshja Plotësuese e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës, e cila është lidhur ndërmjet Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Këshillit të



Evropës dhe nënshkruar më 28 nëntor 2011 nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës Thorbjørn Jagland dhe zëvendëskryeministri i Luksemburgut, ministri i Punëve të Jashtme Jean Asselbom, në lidhje me EPA-në;

*duke pranuar* me kënaqësi partneritetin solid që është krijuar ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian në fushën e rrugëve kulturore dhe të turizmit kulturor, dhe duke mbështetur forcimin e vazhdueshëm të këtij partneriteti në të ardhmen, duke përfshirë anëtarësimin e Bashkimit Evropian në EPA sa më shpejt të jetë e mundur;

*duke njohur* mbështetjen vendimtare politike të Parlamentit Evropian në themelimin e EPA-së;

gjithashtu, *duke vënë në dukje* aktivitetet e reja që janë iniciuar me organizata të tjera ndërkombëtare, si Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara (WTO), OECD dhe UNESCO, në këtë fushë dhe duke inkurajuar zhvillimin e mëtejshëm të këtyre partneriteteve;

*duke pranuar* rëndësinë e rrugëve kulturore, në lidhje me bashkëpunimin kulturor ndërkufitar dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm kulturor, i cili bazohet në njohuritë, aftësitë dhe pasuritë e trashëgimisë lokale, duke promovuar Evropën – duke përfshirë rajone më pak të njohura – si një destinacion që ofron një përvojë unike kulturore;

*duke konsideruar se* EPA ofron një mjet të përshtatshëm operacional për të mbështetur zhvillimin dhe promovimin e rrugëve kulturore ekzistuese dhe të reja;

*duke marrë parasysh* rezolutën CM/Res (2010)53, që krijon një marrëveshje të zgjeruar të pjesshme mbi rrugët kulturore për një periudhë fillestare prej tre vjetësh;

*duke iu referuar* rezolutës CM/Res(2013)67 për rregullat për dhënien e certifikimit të “Rrugës Kulturore të Këshillit të Evropës”;

*duke marrë parasysh* rezolutën statutores Res(93)28 mbi marrëveshjet e pjesshme dhe të zgjeruara të miratuara nga Komiteti i Ministrave, më 14 maj 1993, në sesionin e tij të 92-të;

*duke pasur parasysh* rezolutën Res(96)36, që përcakton kriteret për marrëveshjet e pjesshme dhe të zgjeruara të Këshillit të Evropës, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17 tetor 1996, në takimin e 575-të të zëvendësministrave, të ndryshuar me rezolutën CM/Res (2010)2, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 maj 2010, në mbledhjen e 1084-të të zëvendësministrave,

Vendosin si më poshtë:

1. Konfirmohet Marrëveshja e Pjesshme e Zgjeruar për Rrugët Kulturore (EPA), e cila do të menaxhohet në përputhje me dispozitat e përfshira në statutin bashkëngjitur të kësaj rezolute.

2. Instituti Evropian i Rrugëve Kulturore do të vazhdojë të funksionojë me mbështetjen financiare të Qeverisë së Luksemburgut nën kujdesin e EPA-së dhe do të ndihmojë në realizimin e programit të tij të aktiviteteve në bazë të marrëveshjes ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe autoriteteve të Luksemburgut të 27 nëntorit 2011, si dhe në bazë të një marrëveshjeje operative ndërmjet Presidentit të Institutit Evropian të Rrugëve Kulturore dhe Sekretarit Ekzekutiv të EPA-së.

3. Shprehin dëshirën që të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera palë në Konventën Evropiane të Kulturës të bëhen anëtarë të Marrëveshjes së Pjesshme të Zgjeruar për Rrugët Kulturore (EPA) në të ardhmen e afërt.

*Shtojca e Rezolutës CM/Res (2013)66*

### **Statuti i rishikuar i Marrëveshjes së Pjesshme të Zgjeruar për Rrugët Kulturore**

Neni 1

#### **Qëllimet dhe detyrat**

##### **1.1 Qëllimet**

Marrëveshja e Pjesshme e Zgjeruar (EPA) do të kontribuojë në promovimin e identitetit dhe të qytetarisë evropiane nëpërmjet njohjes dhe ndërgjegjësimit për trashëgiminë e përbashkët të Evropës, dhe zhvillimit të lidhjeve kulturore dhe dialogut brenda Evropës, edhe me vende dhe rajone të tjera. Kjo marrëveshje do të synojë t'i japë formë një hapësirë të përbashkët kulturore nëpërmjet zhvillimit të rrugëve kulturore, që synojnë të nxisin ndërgjegjësimin për trashëgiminë, arsimin, rrjetëzimin, turizmin ndërkufitar cilësor dhe të qëndrueshëm dhe aktivitete të tjera të ngjashme.

EPA-ja do të kontribuojë në përforcimin e potencialit të rrugëve kulturore për bashkëpunim kulturor, zhvillim të qëndrueshëm territorial dhe kohezion social, me fokus të veçantë në temat me rëndësi simbolike për unitetin, historinë, kulturën dhe vlerat evropiane dhe në zbulimin e destinacioneve më pak të njohura. EPA-ja do të



forcojë dimensionin demokratik të shkëmbimit kulturor dhe turizmit nëpërmjet përfshirjes së rrjeteve dhe shoqatave bazë, autoriteteve lokale dhe rajonale, universiteteve dhe organizatave profesionale. Do të kontribuojë në ruajtjen e një trashëgimie të larmishme përmes itinerareve turistike tematike dhe alternative, si dhe përmes projekteve kulturore.

EPA-ja do të kontribuojë në zhvillimin dhe në promovimin e konceptit të rrugëve kulturore në të gjitha aspektet, në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin global për Evropën si një destinacion turistik me një vlerë dhe cilësi unike.

### **Përkufizimet**

“Rruga kulturore” një projekt i bashkëpunimit kulturor, trashëgimisë arsimore dhe turistike, që synon zhvillimin dhe promovimin e një itinerari ose një serie itineraresh bazuar në një rrugë historike, një koncept, figurë ose fenomen kulturor me një rëndësi që i kalon kufijtë e një shteti për të kuptuar dhe për të respektuar vlerat e përbashkëta evropiane.

“Operatori i rrugës kulturore” një organizatë ose një grup organizatash të regjistruara ligjërisht në një ose disa nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, ose një institucion publik, i cili mban përgjegjësinë ligjore, financiare dhe morale për menaxhimin dhe funksionimin e një rruge kulturore dhe përfaqëson rrugën drejt Këshillit të Evropës.

Certifikimi i “Rrugës kulturore të Këshillit të Evropës”, certifikimi i dhënë rrugëve kulturore që plotësojnë kriteret e përshkruara në rregullat e CM/Res (2013)67 për dhënien e certifikatës “Rruga kulturore e Këshillit të Evropës”.

### **1.2 Detyrat**

**Krijimi i politikave dhe vendosja e standardeve**

EPA-ja, duke u mbështetur veçanërisht në ekspertizën e Institutit Evropian të Rrugëve Kulturore, do të ofrojë këshillim dhe asistencën e ekspertëve për zhvillimin, zbatimin, vlerësimin dhe promovimin e rrugëve kulturore. Kjo përfshin ekspertizë në:

- ngritjen dhe funksionimin e rrjeteve dhe organizatave të projektit dhe zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit;

- kërkime mbi sfondin historik të rrugëve, zhvillimin e kulturës, përmbajtjen edukative dhe aktivitetet e rrugëve kulturore;

- zhvillimi i një oferte të qëndrueshme turistike të bazuar në rrugët kulturore, duke kontribuar kështu në mirëqenien ekonomike të rajoneve;

- përgatitjen dhe zbatimin e strategjive të financimit dhe të promovimit;

- trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për operatorët e rrugëve kulturore, veçanërisht në lidhje me Këshillin e Evropës dhe standardet e tjera ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë dhe të kulturës, si dhe standardet e praktikës profesionale në fushën e turizmit;

- Promovimin, vizibilitetin dhe të gjitha aspektet e tjera, që janë në pajtueshmëri me standardet e Këshillit të Evropës.

EPA-ja do të mbështesë rrjetëzimin dhe shkëmbimin ndërmjet operatorëve të rrugëve kulturore dhe partnerëve të tjerë në fushën e turizmit kulturor, në veçanti për:

- zhvillimin e një vizioni dhe strategjie të përbashkët për rrugët kulturore, si produkte turistike;

- zhvillimin e partneriteteve për të rritur burimet e disponueshme për turizmin kulturor në Evropë;

- identifikimin dhe përhapjen e praktikave të mira.

EPA-ja do të kontribuojë në zhvillimin e orientimeve dhe të standardeve të reja, në lidhje me rrugët kulturore dhe turizmin, në përgjigje të sfidave dhe të shqetësimeve të shoqërive moderne.

EPA-ja do të zhvillojë metodologji të mëtejshme për promovimin e turizmit kulturor ndërkufitar.

EPA-ja do t'i japë certifikatën e Rrugës Kulturore të Këshillit të Evropës, në përputhje me Rezolutën CM/Res(2013)67, duke ndjekur rregullat për dhënien e certifikatës së Rrugës Kulturore të Këshillit të Evropës.

### **1.3 Programi i aktiviteteve**

EPA-ja do të zbatojë një program aktiviteteve të vendosura nga Bordi Drejtues.

#### **Neni 2**

#### **Aderimi dhe pjesëmarrja**

2.1 Çdo shtet anëtar i Këshillit të Evropës ose një Palë Kontraktuese e Konventës Evropiane të Kulturës, si dhe Bashkimi Evropian, mund t'i bashkohen EPA-së me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.



2.2 Komiteti i Ministrave, në përbërjen e tij të kufizuar me përfaqësuesit e shteteve anëtare të EPA-së, me shumicën e përcaktuar në nenin 20(d) të Statutit të Këshillit të Evropës, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Evropës për t'iu bashkuar EPA-së, pas konsultimit me anëtarët e EPA-së, që nuk janë anëtarë të Këshillit të Evropës. Një shtet joanëtarë, që merr një ftesë të tillë do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për synimin e tij për t'iu bërë anëtar i EPA-së.

2.3 Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës dhe Palët e tjera Kontraktuese të Konventës Kulturore Evropiane, që nuk i bashkohen EPA-së, mund të kërkojnë statusin e vëzhguesit me EPA-në për një periudhë maksimale njëvjeçare, pa asnjë kontribut financiar. Vendimet për çështje të tilla do të merren nga Bordi Drejtues i EPA-së.

2.4 Bashkimi Evropian është i ftuar të bashkohet me EPA-në, me të njëjtat të drejta dhe detyrime si anëtarët e tjerë të EPA-së. Në pritje të pranimit të tij në EPA, Bashkimi Evropian do të vazhdojë të marrë pjesë në punë në përputhje me marrëveshjet e përcaktuara nga secili organ i EPA-së.

2.5 Në përputhje me Rezolutën Statutore, rezoluta (93)28 mbi marrëveshjet e pjesshme dhe të zgjeruara dhe me kërkesën e tyre, Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara (OMI), OECD dhe UNESCO do të ftohen të marrin pjesë në takimet e EPA-së si vëzhgues pa të drejtë për të votuar.

2.6 Komiteti i Ministrave, në përbërjen e tij i kufizuar për përfaqësuesit e shteteve anëtare të Marrëveshjes së Zgjeruar të Pjesshme, mundet, me shumicën e përcaktuar në nenin 20(d) të Statutit të Këshillit të Evropës, pas konsultimit të anëtarëve të EPA-së, të cilët nuk janë anëtarët e Këshillit të Evropës, të autorizojnë EPA-në të ftojë organizata të tjera ndërqeveritare ndërkombëtare, përfaqësuesin e Rrugëve Kulturore të Këshillit të Evropës, OJQ-të ose organe të tjera që kontribuojnë në objektivat e EPA-së, për të marrë pjesë në punën e saj, pa të drejtë vote.

2.7 Asambleja Parlamentare, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës dhe Konferenca e OJQ-ve, mund të marrin pjesë në punën e EPA-së, në përputhje me nenin 3.5 më poshtë.

### Neni 3 Bordi Drejtues

3.1 Bordi drejtues i EPA-së do të përbëhet nga një përfaqësues i emëruar nga secili anëtar i EPA-së.

3.2 Një anëtar i komitetit ndërqeveritar përkatës, të cilit Bordi Drejtues i raporton për vendimet e tij, do të ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e tij, në mënyrë që ta lehtësojë rolin konsultativ të këtij komiteti, në lidhje me vendimet për certifikimin e parashikuar në Rezolutën CM/Res (2013)67. Modalitetet e konsultimit janë objekt i një dispozite të Rregullores së Punës së Bordit Drejtues.

3.3 Bordi drejtues do të zgjedhë nga radhët e tij një byro të përbërë nga një kryesues, një zëvendëskryetar dhe tre anëtarë të tjerë, për një mandat dyvjeçar, i cili mund të rinovohet vetëm një herë.

3.4 Bordi drejtues do të:

- jetë përgjegjës për zbatimin e përgjithshëm të detyrave që i janë dhënë EPA-së;

- japë certifikatën e Rrugës Kulturore të Këshillit të Evropës në përputhje me Rezolutën CM/Res(2013)67, duke ndjekur rregullat për dhënien e certifikatës “Rruga Kulturore e Këshillit të Evropës”;

- miratojë projektprogramin vjetor të aktiviteteve të EPA-së dhe ta dorëzojë atë, në përputhje me Rregullimet Financiare të Këshillit të Evropës, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në lidhje me përpunimin e projektbuxhetit vjetor, përpara transmetimit të tij në Komitetin Statutor;

- vendosë për projekte në përputhje me prioritetet politike të Këshillit të Evropës;

- mbikëqyrë marrëdhëniet me Institutin Evropian të Rrugëve Kulturore, në mënyrë që të sigurojë konsistencën ndërmjet veprimeve të tij dhe programit të aktiviteteve të EPA-së;

- monitorojë zbatimin e programit të një aktiviteti;

- miratojë dhe t'i transmetojë Komitetit të Ministrave një raport vjetor.

3.5 Bordi drejtues mbledhet një herë në vit. Ai mund të ftojë përfaqësues të organeve përkatëse të Këshillit të Evropës që të marrin pjesë në takimet e tij, pa të drejtë vote. Sipas pikave të rendit të ditës.

3.6 Bordi Drejtues mund t'i caktojë detyrat operative Byrosë, me dy të tretat e shumicës.



Byroja thirret nga kryesuesi i Bordit Drejtues të paktën një herë në vit.

3.7 Bordi drejtues i miraton vendimet e tij me dy të tretat e votave të hedhura, ku secili anëtar ka një votë. Çështjet procedurale zgjidhen me shumicën e votave të hedhura. Në të gjitha çështjet e tjera, Bordi Drejtues do të miratojë rregullat e tij të procedurës dhe çdo angazhim tjetër për zbatimin e aktiviteteve të tij.

#### Neni 4

##### **Komisioni Statutor**

4.1 Komiteti Statutor do të përbëhet nga përfaqësuesit në Komitetin e Ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, që marrin pjesë në EPA dhe përfaqësuesit e caktuar posaçërisht për këtë qëllim nga shtetet joanëtare, që marrin pjesë në EPA. Komiteti zbaton *mutatis mutandis* rregullat e procedurës së Komitetit të Ministrave.

4.2 Komiteti Statutor do të përcaktojë çdo vit totalin e kontributeve të detyrueshme të anëtarëve në EPA dhe shkallën e kontributeve, sipas së cilës ky total do të ndahet ndërmjet shteteve pjesëmarrëse; si rregull e përgjithshme, kjo shkallë duhet të jetë në përputhje me kriteret për përcaktimin e shkallës së kontributeve në Buxhetin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

4.3 Komiteti Statutor miraton, çdo vit, buxhetin e EPA-së, për shpenzimet në lidhje me zbatimin e programit të aktiviteteve dhe shpenzimet e përbashkëta të sekretariatit.

4.4 Komiteti Statutor miraton, çdo vit, llogaritë vjetore të EPA-së, të cilat hartohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, në përputhje me Rregullimet Financiare të Këshillit të Evropës dhe i paraqiten Komitetit Statutor të shoqëruar nga raporti i Auditorit të Jashtëm, siç parashikohet në Rregullimet Financiare. Për të shkarkuar Sekretarin e Përgjithshëm, në lidhje me menaxhimin e tij ose të saj për vitin financiar në fjalë, Komiteti Statutor i transmeton Komitetit të Ministrave llogaritë vjetore, së bashku me miratimin e tij ose çdo koment së bashku me komentet e paraqitura nga bordi drejtues dhe raporti i hartuar nga auditori i jashtëm, siç parashikohet në Rregullimet Financiare.

#### Neni 5

##### **Forumi Këshillimor i Rugëve Kulturore**

5.1 Një takim i përfaqësuesve të operatorëve të rrugëve kulturore, rrjeteve, organizatave dhe platformave të trashëgimisë ndërkombëtare dhe turizmit, autoriteteve lokale dhe rajonale, organizatave të shoqërisë civile, Dhomave të Tregtisë, fondacioneve dhe organizatave të tjera donatore, organizatat profesionale në fushën e turizmit, trashëgimisë dhe kulturës ose organeve të tjera përkatëse do të zhvillohet çdo vit në formën e një Forumi Këshillues për Rugët Kulturore.

5.2 Pjesëmarrja në Forum do të bëhet me ftesë ose regjistrim të pranuar nga Sekretariati i EPA-së.

5.3 Forumi do të diskutojë tendencat dhe sfidat në lidhje me rrugët kulturore dhe do të sigurojë një platformë për shkëmbimin e përvojës, rishikimin e progresit me zbatimin e rrugëve kulturore, debatet mbi praktikën e reja profesionale, fillimin e iniciativave të reja dhe zhvillimin e partneriteteve.

#### Neni 6

##### **Buxheti**

6.1 Burimet EPA do të përfshijnë:

- kontributet vjetore nga çdo anëtar që i bashkohet EPA-së;

- çdo pagesë tjetër, dhurim ose trashëgimi, që u nënshtrohet dispozitave të paragrafit 6.3 më poshtë.

EPA mund të marrë kontribute nga Bashkimi Evropian.

6.2 Shpenzimet lidhur me zbatimin e programit të aktiviteteve dhe me shpenzimet e sekretariatit të përbashkët do të mbulohen nga buxheti i pjesshëm i marrëveshjes i financuar nga anëtarët e EPA-së. Shpenzimet për selinë e EPA-së, si dhe ato që lidhen me personelin dhe kostot operative të Institutit Evropian të Rugëve Kulturore do të shfaqen në llogaritë e EPA-së si objekt informacioni.

6.3 EPA, gjithashtu, mund të marrë, gjithashtu, kontribute vullnetare dhe të tjera lidhur me punën e marrëveshjes, duke iu nënshtuar autorizimit të Bordit Drejtues para pranimit të tyre. Këto kontribute do të paguheshin në një llogari të veçantë, të hapur sipas kushteve të nenit 4.2 të Rregullimeve Financiare të Këshillit të Evropës, të monitoruara nga bordi drejtues dhe do të caktohen për



objektivat dhe detyrat e specifikuar, me kusht që ata të jenë në përputhje me synimet e statutit.

6.4 Asetet EPA do të blihen dhe do të mbahen në emër të Këshillit të Evropës dhe do të përfitojnë si të tilla nga privilegjet dhe imunitetet e zbatueshme për asetet e Këshillit, sipas marrëveshjeve ekzistuese.

6.5 Shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës së personave që marrin pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues dhe të Byrosë së tij dhe, sipas rastit, edhe të Komitetit Statutor, do të përballohen nga shteti ose organizata përkatëse.

6.6 Shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës së personave që marrin pjesë në Forumin Këshillues për Rrugët Kulturore do të paguhen nga pjesëmarrësit, përveç nëse vendoset ndryshe nga Bordi Drejtues, në bazë të alokimeve për qëllime të veçanta të specifikuar në buxhetin operacional të EPA-së.

6.7 Rregullimet Financiare të Këshillit të Evropës do të zbatohen, për miratimin dhe menaxhimin e buxhetit EPA.

#### Neni 7

##### **Sekretariati**

7.1 Sekretariati i EPA-së i kryesuar nga një Sekretar Ekzekutiv, do të emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

7.2 Sekretari Ekzekutiv mund të thërrasë institucionet dhe ekspertët e pavarur në fushat e përfshira në program.

7.3 Selia e EPA-së ndodhet në Luksemburg, në ambientet e Institutit Evropian të Rrugëve Kulturore, me mirëkuptimin e Qeverisë së Luksemburgut.

#### Neni 8

##### **Ndryshimet**

Komiteti i Ministrave, në përbërjen e tij i kufizuar për përfaqësuesit e Shteteve anëtare të EPA-së dhe pas konsultimit me anëtarët e EPA-së, që nuk janë anëtarë të Këshillit të Evropës, mund të miratojë ndryshimet në këtë statut me shumicën e parashikuar në nenin 20(d) të Statutit të Këshillit të Evropës.

#### Neni 9

##### **Heqja dorë**

9.1 Çdo anëtar mund të tërhiqet nga EPA-ja me anë të një deklarate dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Faqe | 8110

9.2 Sekretari i Përgjithshëm do të konfirmojë marrjen e deklaratës dhe do të njoftojë anëtarët e EPA-së.

9.3 Në analogji me nenin 7 të Statutit të Këshillit të Evropës, tërheqja do të hyjë në fuqi:

- në fund të vitit financiar në të cilin është njoftuar, nëse një njoftim i tillë është dhënë para 1 qershorit të atij viti financiar;

- në fund të vitit financiar pasues, nëse njoftimi për tërheqjen është dhënë në ose pas 1 qershorit të vitit financiar.

9.4 Në përputhje me nenin 18 të Rregullimeve Financiare të Këshillit të Evropës, Bordi Drejtues shqyrton pasojat financiare të tërheqjes së një anëtari dhe merr masat e duhura.

9.5 Sekretari i Përgjithshëm do të informojë menjëherë anëtarin e interesuar për pasojat e tërheqjes së tij.

#### **DEKRET**

**Nr. 13555, datë 13.4.2022**

#### **PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

#### **DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 29/2022, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

#### **DEKRET**

**Nr. 13540, datë 7.4.2022**

#### **PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 16 e 20, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,



## DEKRETOJ:

## Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Jorgaq Spiro Dhimitri
2. Athina Mitro Hanxhara (Ciko)
3. Sofia Nikolla Mingo
4. Ela (Enkela) Pellumb (Pllumb) Duman (Kurti)
5. Medi Ismet Bregasi
6. Theodhor Vasil Mingo
7. Vasillo Pano Kapurani (Disho)

## Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

## DEKRET

**Nr. 13559, datë 13.4.2022**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

## DEKRETOJ:

## Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ertil Luan Malaj
2. Julian Mitat Pengu
3. Avin Julian Pengu
4. Deni Julian Pengu
5. Aferdita Argjir Nake
6. Elisa Shpend Bajrami
7. Ferdinand Asqeri Asllanaj
8. Evi Pajtim Vreshtazi
9. Denisa Petrit Murati
10. Linda Fatmir Ferhati
11. Pranvera Niko Zhaka
12. Venera Naim Mziu

13. Ermal Ilir Kurti
14. Rebeka Ermal Kurti
15. Brunilda Telha Kurti (Cela)
16. Jonida Jashar Jashari
17. Joela Redjan Jashari
18. Astrit Safet Fero
19. Jon Arben Rakipi
20. Jetnor Dervish Dushku
21. Redjan Xhevat Zazo
22. Saimir Cane Jaho
23. Alba Besnik Zera
24. Leonard Hekuran Meminaj
25. Mariglen Njazi Dade
26. Joana Astrit Uzun (Doko)
27. Krsti Xhorxho Birkelbach (Daka)

## Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

## VENDIM

**Nr. 225, datë 13.4. 2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE,  
TË DOKUMENTACIONIT DHE TË  
MASËS SË KOMPENSIMIT PËR  
SHOQËRITË E LINJAVE TË  
TRANSPORTIT QYTETASE,  
RRETHQYTETASE DHE  
NDËRQYTETASE, PJESË E PAKETËS  
ANTIKRIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

## I. TË PËRGJITHSHME

1. Kompensimin e shoqërive të transportit për linjat qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, në masën 100 (njëqind) lekë për litër karburanti, për një periudhë tremujore: mars, prill, maj 2022. Kompensimi bëhet për shumën e konsumimit të



karburantit për periudhën: mars, prill, maj 2022, por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë të vitit 2021, për secilën nga shoqëritë.

2. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në zërin shpenzime korente të programit 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, i shtohet fondi prej 430 000 000 (katërqind e tridhjetë milionë) lekësh, për kompensimin e shoqërive të transportit për linjat qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase.

## II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFTITIMIN E KOMPENSIMIT

1. Kërkesa për të përfituar kompensimin financiar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, bëhet nga subjekti çdo muaj pranë administratës tatimore nën juridiksionin e së cilës është regjistruar, e cila bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur.

2. Subjektet kërkuuese duhet të paraqesin pranë administratës tatimore, nën juridiksionin e së cilës janë regjistruar, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) kopjen e licencës përkatëse të vlefshme për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas;

c) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;

ç) emrin e bankës, ku subjekti përfitues ka llogarinë rrjedhëse bankare;

d) IBAN-in e llogarisë bankare (jo më shumë se 28 karaktere dhe në monedhën lekë);

dh) shoqëritë që kryejnë vetëm aktivitet të transportit qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas, kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhën: mars, prill, maj, të vitit 2021 dhe 2022;

e) shoqëritë, që përveç aktivitetit të transportit qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas, ushtrojnë edhe aktivitete të tjera, përveç kopjeve të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhën: mars, prill, maj, të vitit 2021 dhe 2022, duhet të paraqesin edhe:

i. vetëdeklarim të sasisë së karburantit të përdorur për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas;

ii. kopje të fletëdaljeve të karburantit gjatë muajve mars, prill, maj, të viteve 2021 dhe 2022, të

përdorur për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas, sipas targave të mjeteve.

3. Kërkesat nga subjektet paraqiten pas datës 10 (dhjetë), të muajit pasardhës, duke filluar nga muaji prill 2022.

4. Në rastin kur konstatohen se në dokumentet e dorëzuara nga subjekti janë të paplota apo kanë mangësi, administrata tatimore, brenda 5 (pesë) ditëve pune, e kthen kërkesën me qëllim plotësimin e dokumentacionit.

5. Administrata tatimore, pas verifikimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, dërgon pranë degës përkatëse të thesarit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, urdhërshtenzimit, duke bashkëlidhur listën përmbledhëse të subjekteve përfituese, sipas bankave të nivelit të dytë, ku përfituesit kanë llogarinë e tyre bankare.

6. Për shoqëritë e regjistruara pas muajit maj, të vitit 2021, si vlerë reference për kompensim do të merret vlera më e lartë e konsumit të karburantit, për periudhën janar–shkurt 2022.

7. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore mund të kryejnë edhe verifikime në vend, në rast konstatimi të pasaktësive në dokumentacionin e paraqitur në kërkesë.

8. Struktura e thesarit në degë, mbas marrjes së urdhërshtenzimit me listën e përfitueseve, sipas pikës 5, të këtij kreu, kryen pagesën brenda 5 (pesë) ditëve pune.

## III. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Kërkesat për kompensim do të pranohen deri në datën 1 gusht 2022.

2. Efekti financiar prej 430 000 000 (katërqind e tridhjetë milionë) lekësh, sipas pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, përballohet nga fondi i kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama



## SHTOJCA NR. 1

**KËRKESË****EMRI I SUBJEKTIT** \_\_\_\_\_**NIPT** \_\_\_\_\_**Banka** \_\_\_\_\_ (vetëm për bankat aktive)**Iban (LEK)** \_\_\_\_\_ (Jo më shumë se 28 karaktere)**\*Bashkëlidhur kësaj kërkesë:**

- Kopja e licencës aktive;
- Vërtetimi i lëshuar nga banka për llogarinë bankare;
- Kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhat: prill, maj, qershor 2021.

**UDHËZIM****Nr. 6, datë 11.4.2022**

**PËR MJETET QË PËRDOREN PËR  
PESHKIMIN ÇLODHËS-ARGËTUES  
DHE MËNYRËN E LËSHIMIT TË  
AUTORIZIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 44, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:****I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

1. Aktiviteti i peshkimit çlodhës-argëtues kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të peshkimit.

2. Gjatë ushtrimit të peshkimit çlodhës-argëtues përdoren në të gjitha kategoritë ujore, këto vegla peshkimi:

- a) jo më shumë se 2 kallama për peshkatar dhe jo më shumë se 3 grepa për kallam;
- b) jo më shumë se 10 grepa dore për peshkatar;
- c) rrjetë e vogël dore.

3. Peshkatori zë jo më shumë se 5 kg produkte peshkore në ditë dhe kjo sasi mund të tejkalohet nëse zihet një individ i vetëm me një peshë më të madhe se 5 kg.

4. Ushtrimi i aktivitetit të peshkimit çlodhës-argëtues kryhet në përputhje me masat e vendosura për ato specie të cilat ndodhen nën një regjim të

kufizuar sforcoje, si ngjalla, toni i kuq dhe peshku shtizë.

5. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit çlodhës-argëtues nuk lejohet të zihen tufat e riprodhuesve.

6. Kërkesa për pajisjen me autorizim për peshkim çlodhës-argëtues kryhet *online* nëpërmjet portalit *e-Albania*, në linkun: <https://e-albania.al/>.

7. Personi mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e të dhënave të plotësuar në formularin e kërkesës.

8. Autorizimi lëshohet nëpërmjet portalit *e-Albania* me kryerjen e pagesës së tarifës së caktuar, sipas formatit të shtojcave II, III, IV dhe V bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

9. Kërkesa për pajisjen me autorizim refuzohet, për shkak të:

- a) mungesës së dokumentacionit të kërkuar;
- b) mungesës së dokumentacionit të përditësuar;
- c) mospërmblotjes së kërkesave të parashikuara në këtë udhëzim për mjetin lundrues të ushtrimit të aktivitetit të peshkimit çlodhës-argëtues.

10. Peshkatarët, gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit çlodhës-argëtues, deklarojnë në mënyrë vullnetare, sipas formularit të shtojcës I (bashkëlidhur) dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

**II. RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PESHKIMIN TURISTIK**

1. Peshkimi turistik nënkupton veprimtaritë e ndërmarra nga çdo individ, person fizik ose juridik, pronar ose posedues i një mjeti lundrues, i cili



imbarkon në anijen e tij persona të tjerë, përveç ekuipazhit për kryerjen e veprimtarive turistike-argëtuese.

2. Aktiviteti i peshkimit turistik kryhet nga peshkatarë profesionistë ose nga profesionistë të peshkimit çlodhës-argëtues me anije peshkimi me flamur shqiptar dhe me mjete lundruese kënaqësie me flamur shqiptar ose të huaj, bazuar në legjislacionin në fuqi.

3. Peshkatar profesionist i peshkimit çlodhës-argëtues është çdo person i cili zë/mbledh një sasi peshku dhe organizmash të tjerë ujorë, nëpërmjet përdorimit të veglave dhe të pajisjeve të lejuara për peshkimin çlodhës-argëtues dhe që nuk ka për qëllim final shitjen, shkëmbimin apo tregtimin e peshkut.

4. Në peshkimin turistik përfshihet:

a) kryerja e aktiviteteve praktike të peshkimit çlodhës-argëtues përmes përdorimit të veglave të peshkimit të parashikuara në këtë udhëzim;

b) kryerja e veprimtarive turistike argëtuese, me qëllim përhapjen dhe zhvillimin e aktivitetit të peshkimit, të tilla si, në veçanti, ekskursione të shkurtra përgjatë brigjeve, vëzhgimi i aktiviteteve profesionale të peshkimit, restorant në bord ose në breg;

c) kryerja e veprimtarive që synojnë njohjen dhe përmirësimin e mjedisit bregdetar, lagunave bregdetare dhe në ujërat e brendshme, me autorizim të autoritetit kompetent, si dhe njohja e publikut të gjerë me aktivitetin e peshkimit tregtar.

5. Aktivitetet e përmendura në pikën 4 të këtij kreu kryhen me kushte të favorshme moti dhe deti, edhe gjatë ditëve të festave zyrtare, nga agimi deri në përfundim, por gjithmonë duke ruajtur distancën nga bregu, të përcaktuar në certifikatat e lëshuara nga organet kompetente.

6. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit turistik në ujërat detare përdoren këto vegla peshkimi:

a) jo më shumë se 3 kurthe për anije;

b) plumbçe me perimetër jo më të madh se 16 metra ose me diametër më të vogël se 5 metra;

c) grumbullim me dorë, pa përdorur vegla peshkimi dhe mjete ndihmëse, të krustaceve dhe molusqeve.

7. Aktiviteti i peshkimit turistik kryhet vetëm me anë të një autorizimi të lëshuar nga MBZHR-ja.

8. Autorizimi për peshkimin turistik është afatshkurtër dhe jepet për periudhën sipas kërkesës së paraqitur, por jo më shumë se 30 ditë.

### III. PESHKIMI TURISTIK I ANIJEVE TË PESHKIMIT ME FLAMUR SHQIPTAR DHE LËSHIMI I AUTORIZIMIT

1. Anijet e peshkimit të përdorura për të kryer aktivitetin e peshkimit turistik janë të detyruara të rikthejnë në portin e nisjes personat e imbarkuar.

2. Lejohet imbarkimi i personave nën 14 vjeç, vetëm nëse janë të shoqëruar nga persona në moshë madhore.

3. Anijet e peshkimit, të cilat zhvillojnë aktivitetin e peshkimit turistik në periudhën 1 nëntor deri më 30 prill, janë të pajisura me infrastrukturë, përfshirë atë të lëvizshme, për mbulimin dhe strehimin e personave në bord.

4. Aktiviteti i peshkimit turistik kryhet me veglat e peshkimit të parashikuara në autorizimin e peshkimit.

5. Pronarët e anijeve të peshkimit të pajisur me leje peshkimi, që kanë rrjeta tërheqëse, ushtrojnë veprimtarinë e peshkimit turistik pas largimit të këtyre rrjetave nga anija e peshkimit dhe të certifikuar nga inspektori i peshkimit të portit të regjistrimit të anijes në fjalë.

6. Veglat e peshkimit me tërheqje të parashikuara në pikën 5 të këtij kreu shkarkohen dhe vulosen përpara fillimit të veprimtarisë së peshkimit turistik, nga inspektori i peshkimit.

7. Kur aktiviteti i peshkimit turistik kryhet duke përdorur veglat e peshkimit të listuara në pikën 6, të kreut II, të këtij udhëzimi, pronari i anijes kujdeset për to, në një mënyrë të tillë që ato të mos bëhen pengesë për kryerjen e aktivitetit normal të bordit, gjatë lundrimit.

8. Personi fizik ose juridik, i cili ka lidhur një kontratë të zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës detare kryen aktivitet të peshkimit turistik vetëm brenda zonës për të cilën ka lidhur kontratë me MBZHR-në.

9. Kërkesa për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit turistik për anijet e peshkimit me flamur shqiptar bëhet në portalin *e-Albania*, në *e-Shërbime* të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në hapësirën “Aplikim për t’u pajisur me autorizim për peshkim çlodhës-argëtues”, duke plotësuar formularin e kërkesës dhe duke ngarkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kopje të lejes së peshkimit;



b) kopje të librit të anijes ose të regjistrit detar ku të përcaktohet numri i personave në bord;

c) kopje të certifikatës së lundrimit të sigurt nga shoqëria klasifikuese e cila duhet të jetë e vlefshme;

ç) policë sigurimi brenda periudhës së vlefshmërisë dhe që garanton jetën, shëndetin e personave dhe përgjegjësinë për dëmet që mund t'u shkaktohen të tretëve.

10. Aktiviteti i peshkimit turistik për anijet e peshkimit me flamur shqiptar kryhet falas, pa pagesë.

11. Autorizimi për peshkimin turistik lëshohet nëpërmjet portalit *e-Albania* brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve teknike.

12. Autorizimi përcakton zonën ku ushtrohet peshkimi turistik dhe numrin e personave të lejuar në bord, i cili duhet të jetë në përputhje me numrin e përcaktuar nga regjistri detar shqiptar për atë mjet lundrues, por jo më shumë se 12 persona në bord, duke përfshirë edhe ekuipazhin.

13. Çdo person që kryen aktivitet peshkimi turistik mban dokumentacionin të përditësuar dhe në rast të ndryshimeve të karakteristikave teknike të anijes së peshkimit bën kërkesë për autorizim të ri.

14. Mjetet e shpëtimit në bord, numri dhe lloji, përcaktohen nga Sektori i Flamurit pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe janë të mjaftueshme për të gjithë personat e imbarkuar.

15. Anijet e peshkimit duhet të kenë certifikatën e lundrimit të sigurt, të vlefshme, sipas shkronjës “c”, të pikës 9, të këtij kreu.

#### IV. PESHKIMI TURISTIK I MJETEVE LUNDRUESE KËNAQËSIE ME FLAMUR SHQIPTAR OSE TË HUAJ DHE LËSHIMI I AUTORIZIMIT

1. Aktiviteti i peshkimit turistik kryhet nga shtetas shqiptarë ose të huaj me një mjet lundrues kënaqësie me flamur shqiptar ose të huaj, që nuk është anije peshkimi, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Mjeti lundrues kënaqësie plotëson të gjitha kushtet dhe rregullat për lundrimin turistik, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Çdo shtetas shqiptar ose i huaj i interesuar për të ushtruar peshkim turistik në ujërat territoriale shqiptare paraqet kërkesë në portalin *e-Albania*, në *e-Shërbime* të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në hapësirën “Aplikim për t'u pajisur me autorizim për peshkim çlodhës-argëtues”.

4. Kërkesa bëhet duke plotësuar formularin e kërkesës dhe duke ngarkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kopje të librit të mjetit lundrues ose të regjistrit detar;

b) kopje të certifikatës së regjistrimit të mjetit lundrues;

c) kopje të dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues;

ç) kopje të certifikatës së lundrimit të sigurt nga shoqëria klasifikuese, e cila duhet të jetë e vlefshme.

5. Autorizimi për peshkimin turistik lëshohet nëpërmjet portalit *e-Albania* brenda 5 (pesë) ditëve pune, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve teknike.

#### V. PESHKIMI SPORTIV

1. Peshkimi sportiv në det dhe në ujëra të brendshme kryhet nga shoqata organizuese nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga MBZHR-ja.

2. Shoqata që organizon peshkimin sportiv njofton MBZHR-në dhe Inspektoratin e Peshkimit mbi ecurinë e këtij aktiviteti dhe sasinë e peshkut të zënë për çdo peshkatar në këtë aktivitet.

3. Në peshkimin sportiv zbatohen të gjitha masat mbrojtëse dhe menaxhuese sikurse në peshkimin tregtar në det dhe në ujëra të brendshme.

4. Me përjashtim të pikës 3, të kreut I, të këtij udhëzimi, sasia e peshkut të zënë gjatë këtij aktiviteti nuk limitohet në rastet e praktikës “kap dhe lësho”.

5. Kërkesa për t'u pajisur me autorizim për peshkimin sportiv bëhet nga një përfaqësues i shoqatës, *online* në portalin *e-Albania*, në *e-Shërbime* të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në hapësirën “Aplikim për t'u pajisur me autorizim për peshkim çlodhës-argëtues”, të paktën 10 (dhjetë) ditë kalendarike përpara datës së caktuar për fillimin e aktivitetit.

6. Kërkesa bëhet duke plotësuar formularin e kërkesës me të dhënat e mëposhtme:

a) gjeneralitetet e përfaqësuesit të shoqatës organizuese (emër, mbiemër; datëlindja; shtetësia; numri i pasaportës ose i kartës së identitetit);

b) të dhënat e shoqatës (emri dhe NIPT/nëse ka);

c) zonën ku do të zhvillohet aktiviteti;

ç) datën dhe orën e zhvillimit të aktivitetit;

7. Në rastin kur kërkesa bëhet nga një përfaqësues i shoqatës, duhet të ngarkohet



autorizimi i shoqatës për përfaqësimin nga aplikanti.

8. Kur aktiviteti i peshkimit sportiv kryhet në zona bashkëmenaxhuese, përfaqësuesi i shoqatës ngarkon një kopje të dokumentit të miratimit nga OMP-të përkatëse.

9. Autorizimi për peshkimin sportiv lëshohet pa pagesë nëpërmjet portalit *e-Albania* dhe brenda 7 (shtatë) ditëve pune, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve teknike.

#### VI. PESHKIMI AMATOR DHE NËNUJOR

1. Peshkimi amator është peshkim jotregtar, i paorganizuar, që kryhet në kohë të lirë me grepa ose vegla të tjera peshkimi, por pa përdorur mjet lundrues.

2. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit amator dhe nënujor, përveç veglave të përmendura në pikën 2, të kreut I të këtij udhëzimi, lejohet të përdoren, në të gjitha kategoritë ujore, këto vegla peshkimi:

- a) shtizë dore;
- b) pushkë nënujore.

3. Kërkesa për t'u pajisur me autorizim për peshkimin amator dhe nënujor bëhet *online* në portalin *e-Albania*, në *e-Shërbime*, në hapësirën "Aplikim për t'u pajisur me autorizim për peshkim çlodhës-argëtues", duke plotësuar formularin e kërkesës dhe duke ngarkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) fotografi të aplikantit;
- b) vërtetim anëtarësie në një shoqatë kombëtare të peshkimit çlodhës-argëtues.

4. Autorizimi lëshohet nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet portalit *e-Albania*, brenda 3 (tre) ditëve pune, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve teknike.

5. Bazuar në pikën 7, të nenit 40, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, në ujërat

e brendshme, të shpallura si zona bashkëmenaxhimi, kërkesa për kryerjen e peshkimit amator paraqitet pranë organizatës përgjegjëse të bashkëmenaxhimit, e cila është autoriteti kompetent që verifikon plotësimin e kriterëve të lejimit dhe që lëshon autorizimin përkatës.

6. Me përjashtim të pikës 5 të këtij kreu, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore është autoriteti kompetent, që verifikon plotësimin e kriterëve të lejimit dhe që lëshon autorizimin përkatës, sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

7. Nuk lejohet peshkimi amator në ujëmbledhësit e bujqësisë, për të cilët është lidhur një kontratë për zhvillim aktiviteti ripopullim/peshkim, si dhe në lagunat bregdetare dhe grykat e tyre të komunikimit me detin.

8. Aktiviteti i peshkimit nënujor kryhet në përputhje me parashikimet e nenit 11/2, të rregullores nr. 1, datë 7.3.2014, "Për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, 'Për peshkimin'", të ndryshuar.

#### VII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet duke filluar nga data 1.5.2022.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**





(SHTOJCA II)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.20\_\_

**AUTORIZIM PËR PESHKIM TURISTIK ME ANIJE PESHKIMI ME FLAMUR SHQIPTAR****Mjeti lundrues:** \_\_\_\_\_

1. Në pronësi të \_\_\_\_\_ ose në përdorim të \_\_\_\_\_

2. Regjistruar në Kapitenarinë e Porteve Durrës

më datë \_\_\_\_\_, me nr. regjstri \_\_\_\_\_

më nr. regj. në Regjistrin Detar \_\_\_\_\_

më nr. regj. në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit **ALB** \_\_\_\_\_

3. Me karakteristika:

viti i prodhimit \_\_\_\_\_, vendi i prodhimit \_\_\_\_\_

ndërtuar me material \_\_\_\_\_

gjatësia \_\_\_\_\_m, gjerësia \_\_\_\_\_m, tonazhi bruto\_\_\_\_, tonazhi neto \_\_\_\_\_, zhytja \_\_\_\_\_ m

me motor tip \_\_\_\_\_

me fuqi motorike \_\_\_\_\_

numri maksimal i personave të lejuar në bord \_\_\_\_\_

## AUTORIZOHET:

Të ushtrojë peshkim çlodhës-argëtues brenda ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Forma e peshkimit: **Peshkim turistik me anije peshkimi me flamur shqiptar.**

Autorizimi është i vlefshëm deri më datë: \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.20\_\_

Vlefshmëria e këtij autorizimi humbet në rast moszbatimi të ligjit nr. 64/2012, “Për Peshkimin”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.

MINISTËR



(SHTOJCA III)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot. Tiranë, më \_\_\_\_\_.20\_\_

**AUTORIZIM PËR PESHKIM TURISTIK ME MJETE LUNDRUESE KËNAQËSIE ME  
FLAMUR SHQIPTAR OSE TË HUAJ**

Mjeti lundrues: \_\_\_\_\_

Flamuri: \_\_\_\_\_

1. Në pronësi të \_\_\_\_\_, në përdorim të \_\_\_\_\_

Shtetësia \_\_\_\_\_, datëlindja \_\_\_\_\_, vendlindja \_\_\_\_\_

2. Regjistruar në \_\_\_\_\_

3. Me karakteristika:

viti i prodhimit \_\_\_\_\_, vendi i prodhimit \_\_\_\_\_

ndërtuar me material \_\_\_\_\_

gjatësia \_\_\_\_m, gjerësia \_\_\_\_m, tonazhi bruto\_\_\_\_, tonazhi neto \_\_\_\_, zhytja \_\_\_\_ m

me motor tip \_\_\_\_\_

me fuqi motorike \_\_\_\_\_

numri maksimal i personave të lejuara në bord \_\_\_\_\_

**AUTORIZOHET:**

Të ushtrojë peshkim çlodhës-argëtues brenda ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Forma e peshkimit: **Peshkim turistik me mjet lundrues kënaqësie.**Autorizimi është i vlefshëm për: **X (iks) ditë, duke filluar nga data \_\_\_\_\_.20\_\_**

Vlefshmëria e këtij autorizimi humbet në rast moszbatimi të ligjit nr. 64/2012, “Për Peshkimin”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.

MINISTËR



(SHTOJCA IV)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot. Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.20\_\_

**AUTORIZIM PËR PESHKIM SPORTIV**

Shoqata/organizata \_\_\_\_\_

**AUTORIZOHET:**

Të ushtrojë peshkim çlodhës-argëtues brenda ujërave territoriale dhe ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë.

Forma e peshkimit: **Peshkim sportiv.**

1. Data kur do të zhvillohet aktiviteti: \_\_\_\_:\_\_\_\_
2. Ora kur do të zhvillohet aktiviteti: \_\_\_\_\_.20\_\_
3. Zona ku do të zhvillohet aktiviteti: \_\_\_\_\_

Vlefshmëria e këtij autorizimi humbet në rast moszbatimi të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.

MINISTËR



(SHTOJCA V)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot. \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_.20\_\_

## AUTORIZIM PËR PESHKIM AMATOR


Z./znj. \_\_\_\_\_

NID: \_\_\_\_\_, datëlindja: \_\_\_\_\_,

Shtetësia: \_\_\_\_\_

Nr. tel.: \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_

Anëtar i shoqatës/organizatës: \_\_\_\_\_



AUTORIZOHET:

Të ushtrojë peshkim çlodhës-argëtues brenda ujërave territoriale dhe ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë.

Forma e peshkimit: **Peshkim amator.**

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti: \_\_\_\_\_

Veglat e peshkimit: \_\_\_\_\_

Autorizimi është i vlefshëm deri më datë: \_\_\_\_\_.20\_\_

Vlefshmëria e këtij autorizimi humbet, në rast moszbatimi të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore ne fuqi.

KRYETARI I BASHKISË

**UDHËZIM****Nr. 7, datë, 7.4.2022****PËR PËRZGJEDHJEN,  
SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E  
TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT  
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 17.6.2020, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollorë të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 17.4.2019, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollorë të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”,

**UDHËZOJ:****1. Katalogu i teksteve shkollorë:**

Nxënësit e klasave 1–12 të arsimit parauniversitar të punojnë me tekstet shkollorë sipas katalogut të teksteve shkollorë, i cili shpallet çdo vit në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al).

2. Përzgjedhja e teksteve shkollorë bëhet nga mësuesit në bazë shkolle, sipas procedurës së mëposhtme:

a) për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së teksteve shkollorë që do të përdorin nxënësit e arsimit parauniversitar, mësuesit grupohen në çdo shkollë në bazë të ekipeve lëndore;

b) procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollorë administrohet nga Komisioni i Administrimit (KA), i përbërë nga tre anëtarë (kryetar, sekretar dhe një anëtar). Komisioni i Administrimit zgjidhet me konsensus nga këshilli i mësuesve të shkollës.

**3. Komisioni i Administrimit ka për detyrë:**

a) të njohë të gjithë mësuesit e shkollës me këtë udhëzim dhe me katalogun bashkëlidhur;

b) të shpallë datën, orën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes për përzgjedhjen të teksteve shkollorë;

c) të japë udhëzimet për të gjitha procedurat që do të ndiqen nga mësuesit;

ç) të administrojë procesverbalet e mësuesve të ekipeve lëndore;

d) të hartojë, mbi bazën e procesverbaleve të mësuesve, tabelën përmbledhëse të teksteve shkollorë për çdo botues/distributor, titujt e të cilëve janë përzgjedhur nga mësuesit. Tabelat përmbledhëse të hartohen në tri kopje origjinale dhe të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KA-së.

4. Mësuesit e klasave dhe të ekipeve lëndore kanë për detyrë:

a) të njihen me të gjitha alternativat e teksteve shkollorë të përfshira në katalog dhe pas diskutimeve për to, të vendosin për tekstin që do të përdoret në secilën klasë/lëndë;

b) përzgjedhja e tekstit bëhet me konsensus. Në rast se mësuesit e klasave ose të ekipeve lëndore nuk bien dakord, përzgjedhja bëhet me votim. Fitues është teksti që merr shumicën e votave;

c) në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollorë ftohen për të qenë të pranishëm prindërit e nxënësve. Prindërit vëzhgojnë procedurat e përzgjedhjes, por nuk marrin pjesë në votim;

ç) mbledhja e mësuesve të klasave dhe e ekipeve lëndore për përzgjedhjen e teksteve bëhet e hapur për prindërit dhe median. Në përfundim, mësuesit e klasave dhe ata të ekipeve lëndore plotësojnë dhe nënshkruajnë procesverbalet e përzgjedhjes së teksteve. Në këto procesverbale pasqyrohet detyrimisht dhe saktë titulli/titujt e përzgjedhur, botuesi/distributori përkatës dhe sasia që do të porositet. Procesverbalet i dorëzohen KA-së.

5. Drejtori i shkollës ka detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:

a) të njohë këshillin e mësuesve me përmbajtjen e këtij udhëzimi dhe të sigurojë katalogun e teksteve shkollorë dhe t'i njohë të gjithë mësuesit e shkollës me të;

b) të miradministrojë të gjithë dokumentacionin që rrjedh nga zbatimi i këtij udhëzimi, përfshirë edhe kopjet e teksteve shkollorë të dërguara/të dorëzuara nga botuesit/distributorët;

c) të inventarizojë detyrimisht në bibliotekën e shkollës kopjet e teksteve shkollorë të dërguara/të dorëzuara nga botuesit/distributorët;

ç) t'i përcjellë zyrtarisht çdo botuesi/distributori një kopje origjinale të tabelës përmbledhëse përkatëse, të hartuar dhe të nënshkruar nga KA-ja. Drejtori mban përgjegjësi për sasinë e teksteve shkollorë të porositura te botuesit/distributorët për klasë/lëndë, në mënyrë që sasia e kërkuar të



plotësojë të gjitha nevojat e nxënësve për tekste shkollore.

d) të dërgojë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, tabelën përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve të përzgjedhura nga shkolla.

6. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), që kanë në varësi shkolla me nxënës të pakicave kombëtare, për tekstet në gjuhën amtare të pakicave kombëtare zbatojnë vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 17.4.2019, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”.

7. Dokumentacioni që rrjedh nga zbatimi i këtij udhëzimi, ruhet në arkivin e shkollës për dy vite kalendarike. Ai të jetë objekt i kontrollit të MAS-it dhe i institucioneve të saj të varësisë.

8. ZVAP-të, kanë për detyrë:

a) të njohin me këtë udhëzim të gjitha drejtoritë e shkollave në varësi;

b) të sigurojnë për të gjitha drejtoritë e shkollave në varësi katalogun e teksteve shkollore, në formën elektronike dhe të shtypur;

c) të hartojnë, mbi bazën e të dhënave të marra nga shkollat e varësisë, tabelën përmbledhëse të teksteve shkollore të përzgjedhura në shkallë ZVAP-je, e cila i dërgohet drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP). DRAP-të i dërgojnë këto të dhëna në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP). DPAP-ja dërgon tabelën përmbledhëse në MAS brenda afateve të parashikuara në urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin.

9. MAS-i, dhe institucionet e saj të varësisë, monitorojnë mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes dhe porosisë së teksteve shkollore, në përputhje me këtë udhëzim.

10. Konflikti i interesit:

a) çdo punonjësi të MAS-it dhe të institucioneve të varësisë i ndalohet ndikimi, në çfarëdolloj forme, në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore;

b) tekstet shkollore që kanë autorë, redaktorë, korrektorë, ilustrues etj., që janë mësues ose drejtues të shkollave, nuk mund të përzgjidhen në shkollat në të cilat ata punojnë;

c) titullari i ZVAP-së, DRAP-së, DPAP-së, çdo punonjës i këtyre institucioneve dhe drejtuesit e shkollave e kanë të ndaluar të bëjnë presion të

rekomandojnë apo të ndikojnë në çfarëdolloj forme apo mënyre te mësuesit në përzgjedhjen e teksteve shkollore. Atyre nuk u lejohet favorizimi i botuesve/distributorëve apo i autorëve të veçantë, si dhe dallimi i teksteve të veçanta në raport me të tjerat. Në rast të verifikimit të shkeljeve të sipërpërmendura, personat përgjegjës penalizohen deri në largim nga detyra;

ç) gjatë procesit të përzgjedhjes së teksteve në shkolla nuk lejohet asnjë veprimtari e botuesve/distributorëve, që ka për qëllim publicitetin e teksteve të tyre.

11. Shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore:

a) botuesit dhe distributorët përkatës janë përgjegjës për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore. Ata duhet ta përfundojnë shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore detyrimisht një javë para fillimit të vitit shkollor;

b) botuesve/distributorëve që shesin tekste shkollore pa pullën me hologramë, apo me çmime të ndryshme nga ato të katalogut të teksteve shkollore të shpallura nga MAS-i, iu hiqen këto tekste nga katalogu i teksteve shkollore;

c) shitja e teksteve shkollore të bëhet nëpërmjet njësisë tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave, nga subjekte të licencuara. Me kërkesën e botuesve apo distributorëve, drejtoritë e shkollave janë të detyruara të vënë në dispozicion falas një ose dy mjedise për shitjen e teksteve shkollore. Tekstet që shiten, duhet të kenë detyrimisht pullën me hologramën e MAS-it;

ç) ndalohet shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore nga punonjës arsimorë, me përjashtim të teksteve për nxënësit e pakicave kombëtare. Shpërndarja dhe shitja për këtë kategori nxënësish mund të bëhet nga punonjës arsimorë të ngarkuar nga ZVAP-ja, dhe drejtoritë e shkollave përkatëse.

d) ZVAP-ja cakton një person përgjegjës (pikë kontakti), në nivel përgjegjës sektori, që mban lidhje të vazhdueshme me DRAP-në dhe DPAP-në për të informuar në vazhdimësi për mbarëvajtjen e procesit;

dh) drejtoria e shkollës, në javën e fundit të vitit shkollor publikon, në vendin më të dukshëm për nxënësit dhe prindërit, listën e teksteve shkollore që do të përdorë shkolla vitin e ardhshëm shkollor, emrin e botuesit/distributorit dhe çmimin e shitjes me pakicë;



e) subjekteve të licencuara për shitjen e teksteve shkollore nuk u lejohej që, bashkë me tekstet shkollore me hologramën e MAS-it, t'u shesin nxënësve tekste që nuk i përkasin katalogut;

ë) ZVAP-të dhe DRAP-të, gjatë dy javëve para fillimit të vitit të ri shkollor dhe një javë pas tij, të raportojnë elektronikisht çdo ditë në DPAP për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore dhe DPAP-ja raporton në MAS;

f) DPAP-ja, DRAP-të, ZVAP-të, dhe drejtuesit e shkollave monitorojnë dhe raportojnë për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore në periudhën qershor–shtator.

12. Përzgjedhja e teksteve përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, për çdo vit shkollor. Procedurat e përzgjedhjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore bëhen në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë udhëzim.

13. Kreu IX i udhëzimit nr. 26, datë 11.12.2017, i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e konkurrimit, miratimit, porositjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale” shfuqizohet.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Evis Kushi**

## URDHËR

Nr. 167, datë 11.4. 2022

### PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENET E OHRIT, PRESPËS, FIERZËS, ULZËS DHE SHKOPETIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdo mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum të të gjitha llojeve të peshqve në liqenet e Ohrit (me përjashtim të koranit), Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit dhe konkretisht:

- *për gjubcën (cironka) – Alburnus Albidus Alborella*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2022, në liqenin e Ohrit dhe prej 1 prillit deri më 31 korrik 2022, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

- *për krapin – Cyprinus Carpio*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2022, në liqenin e Ohrit dhe prej 25 prillit deri më 25 maj 2022, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

2. Për periudhën 20.7.2022 deri më 20.8.2022, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu për liqenin e Ohrit dhe për periudhën 25.4.2022 deri më 25.6.2022, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 150 ml nga bregu për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitetet peshkimi në këto liqene.

5. OMP-të të marrin të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në këto liqene.

6. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të



Peshkimit dhe Akuakulturës, Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit të liqeneve të Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare të qarqeve përkatëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Frida Krifca

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 1.4.2022**

### **BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 ‘Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 6, datë 1.4.2022, si më poshtë:

**I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

**1. Dosje formulare nr. 5130**, në ngarkim të K. B., me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 26 (njëzet e gjashtë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**2. Dosje formulare nr. 736**, në ngarkim të I. M., me 51 (pesëdhjetë e një) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Operativ.

**3. Fashikull i problemit të centralizuar nr. 1146 “Merimanga”**, me 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 38 (tridhjetë e tetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega IV.

**4. Evidenca agjenturale operative e punëtorit operativ nr. 4**, me 233 (dyqind e tridhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Evidenca i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**5. Dosje personale nr. 6065**, “Vigjilenti”, në ngarkim të N. K., me 13 (trembëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 11 (njëmbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**6. Dosje pune nr. 6065**, “Vigjilenti”, në ngarkim të N. K., me 9 (nëntë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**7. Dosje pune nr. 5780**, “Shkëndia”, në ngarkim të P. C., me 40 (dyzet) fletë, ndër të cilat 8 (tetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**8. Dosje personale nr. 5780**, “Shkëndia”, në ngarkim të P. C., me 299 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 47 (dyzet e shtatë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**9. Fashikull nr. 940, 663**, në ngarkim të P. C., me 21 (njëzet e një) fletë, ndër të cilat 5 (pesë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**10. Dosje pune nr. 20**, “Dropulli”, në ngarkim të L. N., me 2 vëllime. Vëllimi i parë ka 261 (dyqind e gjashtëdhjetë e një) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**11. Dosje personale nr. 20**, “Dropulli”, në ngarkim të L. N., 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë, ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 8 (tetë) fletë kanë



nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

**12. Dosje pune nr. 1405, “Drini”,** në ngarkim të I. S., me 83 (dyzet) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 18 (tetëmbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë.

**13. Dosje personale nr. 1405, “Drini”,** në ngarkim të I. S., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 20 (njëzet) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë.

**14. Dosje personale nr. 92, “Aurora”,** në ngarkim të Xh. V., me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë, ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 20 (njëzet) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**15. Dosje pune nr. 92, “Aurora”,** në ngarkim të Xh. V., me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**16. Dosje personale nr. 7367, “Ekran”,** në ngarkim të Y. P., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 10 (dhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**17. Dosje pune nr. 7367, “Ekran”,** në ngarkim të Y. P., me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë ka nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 11 (njëmbëdhjetë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**18. Dosje formulare nr. 252/1,** në ngarkim të A. Ç., me 402 (katërqind e dy) fletë, ndër të cilat 24 (njëzet e katër) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 22 (njëzet e dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**19. Dosje pune nr. 3033, “Lisi”,** me 6 volume. Volumi i parë ka 125 (njëqind e njëzet e pesë) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Volumi i dytë ka 149 (njëqind e dyzet e nëntë) fletë, ndër të cilat 3 (katër) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë ka nivelin e

klasifikimit “Sekret”. Volumi i tretë ka 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë, ndër të cilat 3 (tri) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Volumi i katërt ka 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Volumi i pestë ka 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë, ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Volumi i gjashtë ka 25 (njëzet e një) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë kanë nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETARE  
Gentiana Sula

## VENDIM Nr. 7, datë 1.4.2022

### BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pika “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr.7, datë 1.4.2022 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtëme:

**1. Dosje Formulare nr. 1675,** në ngarkim të S.G., me 27 (njëzet e shtatë) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.



**2. Dosje Përpunimi nr. 1673**, në ngarkim të M.G., me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**3. Dosje Formulare nr. 117**, në ngarkim të N. B., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë ndër të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**4. Dosje Formulare nr. 196**, në ngarkim të V.Xh., me 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 51 (pesëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 3 (tri) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**5. Dosje Formulare nr. 104**, në ngarkim të H.M., me 35 (tridhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”.

Dosja i përket Fondit Operativ.

**6. Dosje Formulare nr. 105**, në ngarkim të I. Gj., me 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 39 (tridhjetë e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 3 (tri) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**7. Dosje Formulare nr. 2642**, në ngarkim të H.M., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë ndër të cilat 30 (tridhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**8. Dosje Formulare nr. 1340**, në ngarkim të M.SH., me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 21 (njëzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**9. Dosje Formulare nr. 727**, në ngarkim të L.G., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**10. Dosje Formulare nr. 717**, në ngarkim të S.T., me 31 (tridhjetë e një) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**11. Dosje Formulare nr. 35**, në ngarkim të A.K., me 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 33 (tridhjetë e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**12. Dosje Formulare nr. 5549**, në ngarkim të M.M., me 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 20 (njëzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**13. Dosje Fashikullore nr. 702**, në ngarkim të A.K., me 14 (katërmëdhjetë) fletë 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**14. Dosje Formulare nr. 628**, në ngarkim të R.M., me 108 (njëqind e tetë) fletë ndër të cilat 25 (njëzet e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**15. Dosje Personale nr. 674**, në ngarkim të H.M., me 22 (njëzet e dy) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret” dosja i përket fondit operativ”.

**16. Dosje formulare nr. 3517**, në ngarkim të A.V., me 490 (katërqind e nëntëdhjetë) ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**17. Dosje formulare nr. 3517/1**, në ngarkim të A.V., me 252 (dyqind e pesëdhjetë e dy) ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Operativ.

**18. Dosje Formulare nr. 1695**, në ngarkim të L.G., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.



Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**19. Dosje Formulare nr. 5527**, në ngarkim të A.P., me 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Operativ.

**20. Dosje Përpunimi nr. 5480**, në ngarkim të N.G., me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**21. Dosje Formulare nr. 6092**, në ngarkim të P.V., me 209 (dyqind e nëntë) fletë ndër të cilat 20 (njëzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**22. Dosje Formulare nr. 4858**, në ngarkim të K.K., me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**23. Dosje Formulare nr. 2091**, në ngarkim të A.R., me 21 (njëzet e një) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

**24. Dosje Personale nr. 10999**, në ngarkim të L.D., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**25. Dosje Pune nr. 10999**, në ngarkim të L.D., me 49 (dyzet e nëntë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1980-1982. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**26. Dosje Formulare nr. 1149**, në ngarkim të Xh.D., me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë ndër të cilat 24 (njëzet e katër) fletë janë të

klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 9 (nëntë) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**27. Dosje Personale nr. 5377**, në ngarkim të H. D., me 49 (dyzet e nëntë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 21 (njëzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**28. Dosje Formulare nr. 1008**, në ngarkim të S.M., me 80 (tetëdhjetë) fletë ndër të cilat 14 (katërmëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**29. Dosje Pune nr. 5377**, në ngarkim të H.D., me 214 (dyqind e katërmëdhjetë) fletë ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

**30. Dosje Përpunimi nr. 2184**, në ngarkim të J.G., me 198 (njëqind e nëntëdhjetë tetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 23 (njëzet e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

**31. Dosje Përpunimi nr. 3365**, në ngarkim të Z.G., me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë ndër të cilat 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

**32. Dosje Personale nr. 3580**, në ngarkim të G.T., me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**33. Dosje Pune nr. 3580**, në ngarkim të G.T., me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë



ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**34. Dosje Personale nr. 2174**, në ngarkim të S.Sh., me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 30 (tridhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**35. Dosje Pune nr. 2174**, në ngarkim të S.Sh., me 195 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**36. Fashikull**, në ngarkim të M.P., me 10 (dhjetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitin 1961.

Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

**37. Dosje Personale nr. 3457**, në ngarkim të E.Sh., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Operativ (mikrofilm).

**38. Dosje e Problemimit të Centralizuar nr. 1199**, “Zvarraniku”, me 20 (njëzet) fletë ndër të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Dega IV.

**39. Dosje Formulare nr. 2907**, në ngarkim të V.P., me 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 47 (dyzet e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Operativ.

**40. Dosje nr. 2183**, në ngarkim të N.Z., me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 29 (njëzet e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

KRYETAR  
Gentiana Sula

## VENDIM

Nr. 58, datë 31.3.2022

### **MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TERFOJA”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 411 prot., datë 28.3.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja” me kapacitet të instaluar 1980 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 14.02.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/3 prot., datë 14.2.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.2.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë



“HEC Terfoja” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pika 4.1.1: plotësuar;

- të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, neni 9, pika 4.1.2: plotësuar;

- dokumentacioni teknik dhe grafik, neni 9, pika 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- Në përfundim të afatit të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 23.1.2023), do t'i kërkohej shoqërisë ta depozitojë lejen nga baseni ujor me afat të rinovuar, brenda datës 23.1.2023.

- Në lidhje me VNM-në paraprake të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), me nr. 2888 prot., datë 9.12.2016, për HEC-in “Terfoje” me kapacitet të instaluar 1980 kw, vlerësojmë se kjo VNM konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim, në kuptim të interpretimit të dërguar në ERE nga AKM-ja, me e-mail-in zyrtar të datës 18.2.2020. Sa i përket kryerjes së punimeve ato janë dokumentuar nga ana e shoqërisë nëpërmjet faturave tatimore të shitjes dhe bilanceve të investitorit që ka kryer punimet e HEC “Terfoje”.

- Kontrata nr. 1173 rep., nr. 510/3 kol., datë 30.5.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Terfoje”, me kapacitet prodhues 1.980 mw, në pellgun ujëmbledhës të përroit të fshatit dhe të përroit të madh, degë e lumit Bushtricë, Bashkia Kukës, qarku Kukës, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por ERE, në zbatim të nenit 38, të

ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoje”; me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. duhet të depozitojë lejen e përdorimit të burimit ujor me afat të rinovuar, brenda datës 23.1.2023.

3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve, sipas përcaktimeve dhe afateve si më sipër.

4. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti



**VENDIM**  
**Nr. 59, datë 31.3.2022**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 411/1 prot., datë 28.3.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 25, datë 14.2.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/3 prot., datë 14.2.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.2.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analizimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., rezultoi se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e

“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2022-1165 (424), datë 11.3.2022, vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Bardhul Metushi, i datëlindjes 16.5.1966, lindur në Martinë, Fier, si dhe caktimin e shtetasit Lulzim Metushi, si kujdestar për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të tij.



*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë